



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 23.14.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMPANISË PËR
MENAXHIMIN E DEPONIVE TË KOSOVËS SH.A
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës sh.a, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Vlora Mehmeti e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Luljeta Morina dhe Senver Morina, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Enver Boqolli.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	33
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	34
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	37
Shtojca IV: Letër konfirmimi	38

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 28/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i KMDK-së.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i Kualifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Çështje Të tjera

Pasqyrat financiare vjetore të KMDK për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një auditor tjetër.


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Dëshirojmë të falënderojmë Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Kryesuesit të Bordit - auditimi 2016

Kryesuesi i Bordit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtaari Kryesor Financiar dhe i Thesarit kur PFV-të dorëzohen në Bordin e Drejtorëve.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i Kualifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Ndërmarrjes Publike "Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës sh.a" për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, PFV për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parimit akrual të kontabilitetit², Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

² Parimi akrual i kontabilitetit - nënkupton, Njohja e transaksioneve dhe ngjarjeve janë të raportuara kur ato të ndodhin e jo kur paraja e gatshme është pranuar ose paguar.

Baza për Opinion të Kualifikuar

Ne kemi krijuar bazën për opinionin të kualifikuar, për arsyet si në vijim:

- Llogarit e arkëtueshme në kontabilitet si dhe në PFV janë prezantuar në vlerë prej 2,778,371€, me një nënvlerësim prej 1,574,057€ për provizionin për borxhin e keq, d.m.th është prezantuar vlera bruto e llogarive të arkëtueshme duke mos përfshirë provizionin. Kjo për shkak se kompania realisht nuk njih provizion për borxhe të këqija edhe pse në kontabilitet kjo konto është ekzistuese. Më tutje, nga konfirmimi i llogarive kemi gjetur nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme edhe për 14,549€;
- Për llogarit e pagueshme për tatim dhe kontribute dhe të tjera të prezantuara në PVF në vlerë prej 267,432€ nuk ishim në gjendje të konfirmojmë vlerën e kësaj llogaritje në mungesë të një raporti apo gjendjes³ nga Administrata Tatimore e Kosovës;
- Detyrimi afatgjatë për të hyrat e shtyra nga grandit janë prezantuar 158,583€ në PVF, mirëpo gjendja e bartur nga viti i kaluar prej 408,785€ nuk ishte e saktë. Kjo pasi që, në pasqyrën e të ardhurave Kompania ka njohur të hyra nga grandet e shtyra vlerën prej 79,721€, e jo 250,203€ sikurse është zvogëluar dhe prezantuar në PVF. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos evidentimit me kohë të këtyre ndryshimeve në kontabilitet nga vitet e më hershme;
- Ekuiteti është prezantuar në PVF në vlerë prej 4,482,406€, përderisa sipas kontabiliteti ishte në vlerë 2,908,350€, kjo ka ndodhur për shkak të evidencave të gabuara kontabël nga vitet e më hershme. Kompania ka prezantuar në PVF edhe një konto të rivlerësimit prej 6,229€, edhe pse kompania nuk kishte bërë rivlerësim të pasurisë gjatë këtij viti; dhe
- Aktiva/Pasiva e bilancit të gjendjes në kontabilitet është prezantuar në vlerë prej 3,755,582€ ndërsa në PVF në vlerë prej 5,331,738€, kjo diferencë ka ndodhur për shkak të provizionimit të borxhit të keq në kontabilitet që ka ndikuar në zvogëlimin e ekuitetit dhe të arkëtueshmeve dhe disa ndryshimeve kontabël që kanë ndodhur në vitin 2016.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Ndërmarrjeve Publike në Kosovë, ZKA është e pavarur nga NP dhe përgjegjësitë tjera etike i janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmia e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin tonë të kualifikuar.

Çështje Të tjera

Pasqyrat financiare vjetore të KMDK për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të kualifikuar të këtyre pasqyrave financiare me 27 prill 2016, për shkak të: shpalosjeve në shënimin tre (3) të pasqyrave financiare vlera bartëse neto e pronës, impianteve dhe pajisjeve nuk janë bartur me koston e tyre ose pas zhvlerësimit; shpalosjeve

³ Raport i gjendjes së përgjithshme të tatimpaguesit i cili gjenerohet nga sistemi i ATK-ës.

në shënimin pesë (5) të pasqyrave financiare të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera edhe pse kishte një zvogëlim të vlerës së tyre në krahasim me vitin paraprak nuk ishin vërejtur se ishin ndërmarrë veprime korigjuese dhe ndarje të provizionive për borxhet e këqija; dhe nuk ka njohur ndonjë provizion për rastet gjyqësore për shkak të disa padive nga disa furnitor për mos pagës të borxheve.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe PFV-të

Kryeshefi ekzekutiv i NP është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligët e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parmit aktual të kontabilitetit si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit tonë. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale. Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse PFV në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi lidhur me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varën nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore;
- Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, KMDK ka për obligim si në vijim:
 - Statuti i NP;
 - Plani i Biznesit;
 - Raportet tremujore me kohë;
 - Raportet operative (të performancës);
 - Raportin vjetor;
 - Raporti nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
 - Draft planin dhe planin përfundimtar të prokurimit me kohë.

Në Memorandumin tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 6/12/2016, ne kemi ngritur disa çështje në lidhje me pasqyrat financiare të cilat mund të kenë ndikim edhe në opinion. Çështjet e ngritura nuk ishin adresuar. Si pasojë, në draft pasqyrat financiare të datës 15/02/2017 ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese që ishin përcjellë me gabime materiale. Përkundër sugjerimeve tona, ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar tek baza për opinion.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, pasqyrat financiare vjetore të përgatitura nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Bordin e Drejtorëve, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Ne kemi identifikuar se KMDK kishte përmbushur kërkesat e lartshënuara.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e cekura më lartë, jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kualifikuar. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet dhe për ta siguruar vlerësimin e saktë të llogarive të arkëtueshme, pasurisë, detyrimeve dhe ekuitetit.

Rekomandimi 2 Prioritet i lartë - Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Pasqyrat Financiare duhet të aprovohen nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për KMDK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e raporteve të NP në përgjithësi.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, ndarjes së detyrave, përmbushjen e kërkesave (kënaqëshmërisë) të konsumatorëve; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekzistojnë disa dobësi në qeverisjen brenda KMDK-së veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Raportet e ndryshme të plotësuara nga KMDK, e pasqyrojnë këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve që nuk bazohen në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit dhe operimi i një sistemi të auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë, nuk janë të vendosura.

KMDK, nuk kishte arritur të zbatoj rekomandimet e dhëna në raportin e auditimit të jashtëm për vitin 2015 si dhe nuk kishte përgatitur ndonjë plan për menaxhim të rrezikut, edhe përkundër që janë identifikuar disa rreziqe domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. KMDK kishte hartuar planin e biznesit, megjithatë ky plan nuk i mbulon të gjitha aktivitetet dhe përmbajta e tij nuk reflekton mundësit reale të ndërmarrjes. Më tutje, as Auditimi i Brendshëm nuk kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe nuk kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

Gjithashtu, mos identifikimi i gabimeve financiare në auditimin e raporteve financiare të vitit 2015, ka rezultuar që këto gabime të barten edhe në pasqyrat financiare të vitit 2016.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti i auditimit të jashtëm⁴ për PFV-të e vitit 2015 të KMDK-së ka rezultuar në 3 (tre) rekomandime kryesore. KMDK nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen rekomandimet e dhëna. Menaxhmenti kishte komentuar të gjeturat në letër menaxhment ku Bordi i Drejtorëve (tutje BD) kishte miratuar këtë raport dhe raportin vjetor për 2015 në mbledhjen e përgjithshme vjetore të BD-së me datë 10.06.2016. Megjithatë, menaxhmenti nuk i kishte zbatuar rekomandimet e dhëna nga auditori i jashtëm.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, asnjë nga 3 rekomandimet e dhëna nuk janë zbatuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

⁴ Raporti i auditimit të jashtëm - Auditimin e PFV të KMDK-ës për vitin 2015 e kishte bërë një kompani private audituese e jo nga ZKA, dhe raportimi i tyre ka përfshirë një raport me opinionin dhe një letër për menaxhmentin ku janë prezantuar të gjeturat me rekomandime.

Çështja 3 – Mos zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- E gjetura** Asnjë nga rekomandimet e vitit të kaluar nuk janë zbatuar ende sepse KMDK nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditimit të Jashtëm.
1. Prona, impiantet dhe pajisjet janë bartur me kosto të tyre duke hequr zhvlerësimin dhe rekomandimi i dhënë për testimin e dëmit të aseteve nga vlerësuesit apo ekspertët, nuk është zbatuar as këtë vit;
 2. Deklarimi apo njohja e provizionit për rastet gjyqësore me qëllim të vlerësimit real të detyrimeve, nuk është zbatuar ende; dhe
 3. Njohja e provizioneve për borxhet e këqija për llogarit e arkëtushme e cila reflekton me njohjen reale të pasurisë nuk është zbatuar ende.
- Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta të cilat ndërlidhen me pasqyrat financiare.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që është përpiluar dhe zbatuar plani i veprimit, nëse paraqitet nevoja i njëjti plan duhet të rishikohet, duke përcaktuar saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Jashtëm, me prioritet në fushat më të rëndësishme.

2.2 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit KMDK operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.2.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Sipas ligjit për NP, KMDK duhet të përgatis një Plan Biznesi për vitin e ardhshëm kalendarik, për të përcaktuar se ku është tani dhe ku planifikohet të arrihet në një periudhë të caktuar tri vjeçare. Ky plan duhet të miratohet nga Bordi i Drejtorëve deri me 31 Tetor të çdo viti kalendarik.

Çështja 4 - Mangësi në planin e biznesit - Prioritet i lartë

E gjetura Plani i biznesit përmban një deklaratë të rrezikut dhe listën e sfidave dhe rreziqeve që do të përballet KMDK, mirëpo nuk përmban edhe veprimet për zvogëlimin/menaxhimin e rreziqeve deri në nivel të pranueshëm. Kompania përballet me rreziqe financiare dhe mungesë të disponueshmerisë së buxhetit, detyrime të trashëguara nga vitet e mëhershme, investimet kapitale të ulëta dhe rreziqe operative, teknologji të vjetruara, kostoja e lartë e shërbimeve, tarifa të ulëta dhe rreziqe të jashtme si infrastrukturore, mjedisore, kushte të tregut dhe të katastrofave.

Sa i përket rreziqeve të katastrofave dhe mjedisore sidomos te Deponia Sanitare e Mirashit kompania bart këtë rrezik te aksionari duke kërkuar ngritje tarifore apo edhe mbështetje financiare për problemin me ujërat e zeza dhe depërtimit në ujërat nëntokësorë të cilat mund të ndotin edhe lumenjtë apo edhe ujërat regionale. Gjasat për ndodhjen e këtij rreziku janë të mëdha dhe ndikimi është shumë i lartë si rrezikim i stafit që punon aty, popullatës përreth, ndotja e ujërave lokale dhe regionale. Për menaxhimin efektiv të rrezikut kompania kishte ndërmarr veprime, mirëpo deri më tani rreziqet domethënëse që kanë ndikim tek organizata nuk kanë arritur të menaxhohen apo sillen në nivel të pranueshëm për shkak të pamundësive financiare.

Për më tepër, Kompania nuk kishte caktuar orarin për realizim të synimeve afariste sipas kërkesave të Ligjit për Ndërmarrje Publike nr.03/L-87 (neni 30.1 pika a).

Rreziku Mungesa e menaxhimit efektiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut do të dobësoj cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve nëse çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur.

Rekomandimi 4 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë përdorur të gjitha mekanizmat për adresimin e çështjeve të identifikuar dhe të bëjë përpjekje për menaxhimin e rrezikut në mënyrë më të përshtatshme për t'i zvogëluar ato deri në nivel të pranueshëm. Kjo mund të bëhet përmes hartimit të planit të veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave dhe duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.

2.2.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 5 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të KMDK-së ka nxjerrë në pah një raportim pjesërisht adekuat financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të ofrimit të shërbimeve. Mirëpo, jo gjithmonë këto raportime kanë qenë të plota dhe të sakta për obligimet, llogarit e arkëtueshme, pasurin dhe ekuitetin. Kjo ka ndodhur për shkak se evidencat kontabël të trashëguara nuk janë azhurnuar me kohë. Përmirësimet nuk ishin bërë edhe pas këshillave tona në memorandumimin e auditimit. Për më tepër, dobësitë e identifikuara në buxhetim, faturim dhe pagesa apo arkëtime, tregojnë se kontrollet menaxheriale nuk janë ende të konsoliduara sa duhet për parandalimin apo evitimin e gabimeve eventuale.

Gjithashtu, mos zbatimi i rekomandimeve nga viti i kaluar dhe aktivitetet e mangëta të NJAB, janë tregues se kontrollet ende nuk janë duke u aplikuar në mënyrë efektive.

Rreziku Cilësia e raportimit të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë ka reduktuar aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e KMDK-së në mënyrë pro aktive si dhe ka ulur efektivitetin e kontrolleve. Mangësitë e identifikuara mund të rezultojnë me raporte të pasakta dhe jo të plota për shfrytëzuesit.

Rekomandimi 5 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është kryer një rishikim detaj për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.

2.3 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me një anëtarë – Auditor i Brendshëm. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës të punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të KMDK-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja dhe sfida të ofruara nga një Komitet efektiv i Auditimit. Raportet e NJAB ishin kryesisht raporte mbi analizën e shpenzimeve dhe të hyrave, prokurimin, shpenzime të derivateve, infrastrukturës të cilat nuk kishin prodhuar ndonjë gjetje apo rekomandim për menaxhmentin. Ne jemi skeptik mbi ofrimin e rishikimeve kualitative të shërbimit të NJAB gjatë kësaj periudhe.

Çështja 6 - Mangësitë në funksionimin e NJAB-së - Prioriteti i lartë

E gjetura	<p>Ekziston një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NJAB-së si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • NJAB nuk kishte plan strategjik dhe Statut të kësaj njësi sipas kërkesave ligjore; dhe • Nga tetë (8) auditime të planifikuara, të cilat nuk kishin të përcaktuar një afat individual kohor, NJAB kishte arritur të përfundoj shtatë (7) raporte duke dhënë vetëm një rekomandim. Raportet nuk kishin formë dhe strukturë të duhur, mungojnë: objektivat e qarta, fushëveprim i auditimit, rezultatet e auditimit si të gjeturat, konkluzione dhe rekomandime, dhe plan i veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Kjo për shkak të mungesës së trajnimit adekuat të Auditorit. Për me tepër pesë (5) auditimet e planifikuara për fusha specifike, ishin zëvendësuar me pesë (5) të tjera. <p>Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e vëmendjes së Menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme apo qeverisjes së mirë. Kjo gjithashtu tregon cilësi të dobët të planifikimit dhe realizimit të auditimit të brendshëm.</p>
Rreziku	<p>Raporti i auditimit të brendshëm i cili nuk pasqyron rreziqet ekzistuese të entitetit, ndikon në mos identifikimin dhe mos adresimin e dobësive në kontrolle duke rezultuar me pasqyra financiare jo të sakta, në jo efikasitet dhe humbje operative.</p>
Rekomandimi 6	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është arritur përfitimi maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm. Komisioni i Auditimit duhet të sigurojë funksionimin adekuat të NJAB-së, duke rishikuar në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik, ofrojnë siguri dhe raportim kualitativ për menaxhmentin.</p>

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në NP. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të KMDK-së kanë nevojë për përmirësime. Edhe pse të hyrat nga shitja nga veprimtaria e saj në vitin 2016 kanë shënuar rritje për 15% krahasuar me vitin 2015, auditimi ynë ka vënë në pah mangësi lidhur me pajtueshmërinë me ligje. Kjo tregon nevojën për forcimin e kontrolleve në këtë fushë. Proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit nuk ishin adekuate. Buxheti fillestar për investime kapitale krahasuar me atë final tregon trend ulës për 50% dhe ky është një tregues i planifikimit jo të duhur për këtë kategori.

Më tutje, edhe shpenzimet për paga dhe mëditje nuk ishin menaxhuar si duhet. Procedurat e rekrutimit për pune specifike nuk ishin në pajtim me Ligjin e punës dhe nuk kishin siguruar transparencë të punësimit, konkurrencë dhe trajtim të barabartë me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës.

Edhe menaxhimi i shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe investime kapitale ka nevojë për përmirësim. Kjo pasi që, mungonte raporti i pranimit të mallrave, miratimi paraprak i kërkesave për blerje, mungonte vendimi për limitimin e shpenzimeve. Mangësitë e identifikuara rrezikojnë që pranimi i punëve apo pajisjeve të jetë jo cilësor dhe jashtë kushteve kontraktuese.

Po ashtu, kontrollet ekzistuese në menaxhimin e pasurive kapitale, llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve nuk janë adekuate. Ato kanë pamundësuar regjistrimin dhe raportimin e saktë dhe të plotë të këtyre llogarive si në regjistrat e brendshëm ashtu edhe në PVF.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga Bordi i Drejtorëve për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin në KMDK.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për KMDK, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e faturuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Kategoritë ekonomike të planifikuara dhe të realizuara në €

Nr.	Përshkrimi	Planifikimi fillestar 2016	Planifikimi i rishikuar 2016	Realizimi 2016	Realizimi 2015
1	Të hyrat ⁵	1,795,234	1,858,645	1,851,415	1,520,617
2	Shpenzimet	(2,587,143)	(2,526,068)	(2,175,193) ⁶	(2,180,069)
3	Të ardhurat jo operative	600,000	723,318		
4	Të hyrat nga grandit		97,542		
5	Fitimi/Humbja (1-2)	(191,909)	153,437	(323,778)	(659,452)

KMDK nuk kishte arritur të realizoj të hyra tjera nga grandet apo donacionet, kryesisht aktivitetin e vet e kishte mbuluar nga të hyrat nga shitja dhe subvencionimi i qeverisë në fund të vitit.

Të hyrat e realizuara në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015 ishin rritur 330,792€. Rritja ishte kryesisht rezultat i rritjes së të hyrave nga shitja nga veprimtaria e saj për 15% krahasuar me 2015., për më shumë referoju nënkaptullit 3.4 Të hyrat.

Më tutje të hyrat tjera ishin nga subvencionimi nga Qeveria e Kosovës ej 200,000€, një e hyrë e njëhershme nga konfiskimi i garancionit të ekzekutimit prej 11,000€, të hyrat e shtyra nga grandit 79,721€, një e hyrë përmes përmbaruesit 783€ dhe një e hyrë nga ndëshkimi me komision disiplinorë në vlerë prej 792€.

Të hyrat e shtyra nga grandet paraqesin zvogëlimin e obligimeve afatgjata për avanset (ose të hyrat e shtyra nga grandit sipas kontabilitetit).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit në €

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet sipas kategorive ekonomike:	2,587,143	2,526,068	2,359,563⁷	2,267,856
Pagat dhe Mëditjet	664,382	660,332	601,366	585,074
Mallrat dhe Shërbimet përfshirë komunalit	1,033,790	794,765	701,847	755,143
Zhvlerësimi	888,971	888,971	871,980	839,852
Investimet Kapitale	0	182,000	184,370	87,787

⁵ Të Hyrat, përfshijnë: të hyrat nga veprimtaria e NP, nga Grantet dhe nga kreditë (nëse ka)

⁶ Shpenzimet janë prezantuar sipas Pasqyrës së të Ardhurave, pa aktiviteti investues

⁷ Janë përfshirë edhe aktivitetet investive

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti i ndarë për Investimet Kapitale ishte destinuar kryesisht për shpenzim për pjesë rezervë/mirëmbajtje investive (146,000€), mirëmbajtje e infrastrukturës (90,000€) dhe vendosja e sistemit të kamerave (5,000€). KMDK me buxhet fillestar nuk kishte ndarë aktivitetin Investues nga ai Operativ, kjo ishte bërë tek me rishikimin e buxhetit të datës 28.07.2016. Pavarësisht kësaj me rishikim të buxhetit ishin identifikuar zërat investues sipas buxhetit fillestar në vlerë 368,000€ dhe me rishikim ky buxhet ishte zvogëluar në 241,000€ duke heq disa investime (si blerja e kamionit prej 100,000€ dhe blerja e veturës 22,000€) dhe zvogëluar disa pozicione tjera (digjitalizimi i peshoreve ishte riemëruar me rishikim si vendosje e kamerave duke pësuar një zvogëlim buxhetor prej 10,000€ në 5,000€). Ndryshimet buxhetore ishin pasoj e vendimit të gjykatës për pagesën e një detyrimi të më hershëm ndaj një furnitori. Gjithashtu, me vendimin e datës 29.11.2016, Bordi i Drejtorëve (BD) kishte ri-destinuar mjetet nga investimet kapitale prej 59,000€ në shpenzime operative. Ri-destinimi i mjeteve në fund të muajit nëntor është tregues për një planifikim jo të duhur të kësaj kategori e cila pason me mosarritje të objektivave të caktuara me synime fillestare;
- Buxheti i ndarë për Paga dhe Mëditje, ishte në vlerë prej 664,382€ duke parashikuar pagesën për përvojën në punë. Me rishikim, KMDK ka zvogëluar buxhetin në 660,332€ si pasojë e mos pagesës së përvojës së punës. Buxhetimi i pagave është bërë vetëm për pagën bazë duke përfshirë edhe shujtën. Realizimi i pagave përfshin pagën bazë, shujtën, kontributin e punëdhënësit, bonuset, stimulimet, shtesat tjera si puna jashtë orarit të rregullt dhe gjithashtu kishte një tepriçë të buxhetit për shkak të planifikimit jo adekuat të kësaj kategorie. Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje krahasuar me vitin e kaluar ishte si pasojë e rritjes së shujtës, disa pozitive të reja, rritjes së pagesave për BD, përvojën e punës e cila edhe pse ishte planifikuar nuk është aplikuar gjatë periudhës;
- Buxheti i ndarë për Mallra dhe Shërbime, ishte destinuar për udhëtime zyrtar, riparim dhe mirëmbajtje, shpenzime të vajrave dhe naftës, shërbime konsulente, shpenzime administrative dhe shpenzime tjera në vlerë prej 794,765€. Me vendimin e datës 31.10.16 BD kishte bërë ri-destinim të mjeteve financiar prej shërbimeve të konsulencës dhe trajnimeve në vlerë 9,000€, në pozicionin mëditje, udhëtime dhe reprezentacion. Sidoqoftë, suficiti kundrejt buxhetit është për shkak të planifikimit jo adekuat të tyre;
- Arkëtimi i parasë vetëm nga aktivitet operative sipas Pasqyrës së rrjedhës së parasë, ishte në vlerën prej 1,990,346€, krahasuar me vitin paraprak prej 1,680,630€ me një rritje prej 311,675€.

Arkëtim të parasë nga aktivitetet e financuara, KMDK ka prezantuar Subvencionimin nga qeveria prej 200,000€ krahasuar me vitin e mëparshëm prej 59,347€ me një rritje prej 140,653€.

Çështja 7 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Buxheti fillestar për investime kapitale krahasuar me atë final tregon trend ulës për 50% dhe kjo është një tregues i planifikimit jo të duhur për këtë kategori, për shkak të përballjes me një rast gjyqësor gjatë vitit 2016. Gjithashtu, KMDK kishte buxhet më të ulët se sa realizimi apo pagesat për investime kapitale kjo për shkak të planifikimit jo adekuat.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimi i dobët do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.

3.2 Të hyrat

Të hyrat në 2016 ishin në vlerë 1,851,415€. Këto kanë të bëjnë me të hyrat nga veprimtaria në vlerë prej 1,559,119€ dhe të hyra tjera në vlerë prej 292,296€ sipas pasqyrës së të ardhurave.

Tabela 3. Të hyrat e planifikuara dhe faturuara në €:

Përshkrimi	Buxheti fillestar 2016	Buxheti final 2016	Realizimi 2016	Realizimi 2015
Të hyrat	2,395,234	2,679,505	1,851,415	1,520,617
Të hyrat nga KRM ⁸	980,942	1,152,642	1,559,119 ⁹	1,350,236
Të hyrat nga klientët privat	203,485	171,884		
Të hyrat nga mbetjet shtazore	126,000	49,312		
Të hyrat nga marrëveshjet e KRM	484,807	484,807		
Të hyrat jo operative (burime tjera)	600,000	723,318	12,575	170,381
Të hyrat nga grandet e shtyra		97,542	79,721	
Të hyrat nga subvencionet	0	0	200,000	-

Për vitin 2016, të hyrat e realizuara nga veprimtaria e saj ishin në vlerë 1,559,119€, ndërsa në vitin paraprak ishin 1,350,236€, me një rritje në 2016 prej 15%. KMDK gjatë vitit 2101, kishte arritur të realizojë të hyra 13.5% më lartë se planifikimi. Kjo vetëm për të hyrat e rregullta që përfshijnë të

⁸ KRM – Kompanitë Rajonale të Mbeturinave

⁹ Në këtë shumë janë të prezantuara të hyrat nga kategoria e klientëve privat, KRM-ve dhe nga mbetjet shtazore.

hyrat nga KRM-të, klientët privat dhe nga mbetjet shtazore. Krahasuar me vitin e kaluar të hyrat e realizuara nga shitja ishin rritur për 208,883€ duke treguar një performancë më të mirë në realizim.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2.1 Të Hyrat nga veprimtaria e NP

Realizimi i të hyrave të rregullta për 2016 ishte në vlerë 1,559,119€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga KRM-të, klientët privat dhe të hyrat nga mbetjet shtazore.

Çështja 8 - Mangësi në pajtueshmërinë me ligjet - Prioritet i lartë

E gjetura

Gjatë testimit të kësaj kategorie kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- KMDK nuk kishte arritur të siguroj licencim të Deponive Sanitare, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-60 (neni 16 pika 1). Edhe përkundër përpjekjeve për sigurimin e saj, nga viti 2012, KMDK operon pa licencë të vazhduar, për shkak të mos përgjigjes nga organi kompetent;
- KMDK nuk kishte arritur të përcaktoj tarifën për mbledhjen e mbeturinave sipas kërkesave të Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-60, faturimi bëhet sipas një tarifore të trashëguar prej ZRRUM¹⁰ nga 2012 në vlerë prej 5.31€/ton për mbledhjen e mbeturinave. Edhe përkundër përpjekjeve dhe kërkesave që KMDK-ja ka bërë ndaj MZHE-së, si institucion kompetent për caktimin e tarifores sipas ligjvënësit, faturimi i të hyrave vazhdon me të njëjtën bazë duke i shtuar edhe TVSH prej 8%; dhe
- Paraqitja e nevojës për deponimin e mbetjeve shtazore, mbeturinave të qelqit dhe disa asgjësimeve nga doganat, nuk ka pasur ndonjë tarifë të caktuar më herët apo licencim për mbledhjen e kësaj mbeturine. Për këto BD e ka vendosur një tarifë prej 70€/ton, ndërsa këtë tarifë me 26.01.2016 e ka zbritur në 50€/ton. Por për të njëjtin aktivitet, KMDK duhet të licencohet dhe caktohen tarifat sipas Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-60. Po ashtu, edhe tarifa për mbeturinat e dheut është përcaktuar nga vet kompania.

¹⁰ ZRRUM - Zyra e Rregullatorit të Ujërave dhe Mbeturinave

Rreziku Mangësitë e identifikuara reflektojnë mosrespektim të rregullave në fuqi dhe menaxhim jo të duhur të deponimit të mbeturinave sidomos të mbeturinat që kërkojnë asgjësim.

Rekomandimi 8 Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë hapa shtesë me qëllim të sigurimit të licencës dhe caktimit të tarifave nga organet kompetente.

Çështja 9 - Mangësitë në faturimin e të hyrave - Prioritet i mesëm

E gjetura Edhe përkundër kontrolleve të vendosura, KMDK kishte dobësi në faturimin dhe mbledhjen e të hyrave si në vijim:

- Fletëngarkesa me nr. 2322 është faturuar dy herë për të njëjtën sasi me tarifa të ndryshme. Në njërin rast është faturuar me 5.31€/ton, ndërsa në rastin tjetër është faturuar me 70€/ton, për këtë çështje KMDK pas këshillave nga auditori kishte njoftuar klientin dhe aplikuar masat korrigjuese; dhe
- Në një rast lloji i mbeturinës në fletëngarkesë (me nr. 029916) nuk ishte evidentuar si duhet. Evidentimi si mbeturinë shtazore me çmim 70€/ton duhej të ishte 5.31€/ton e cila i paraprin faturës. Kjo ka ndodhe për shkak të kontrolleve të brendshme joadekuate.

Rreziku Mangësitë e identifikuara kanë reflektuar me kontrolle të dobëta në menaxhimin e të hyrave. Të hyrat mund të jenë subjekt i manipulimit mashtrues ose gabimit.

Rekomandimi 9 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që sistemi i përshtatshëm i regjistrimit është vënë në funksion për të mbështetur mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Kjo duhet të reflektojë kompleksitetin e sistemit të të hyrave me të cilën operon Kompania. Gjithashtu, të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim për të gjeturat e auditimit në nivel të rastit ku proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive për të përcaktuar se pse kanë ndodhur dështimet dhe pse nuk është aplikuar mbikëqyrja e përshtatshme.

3.2.2 Të hyrat nga burimet tjera (grantet nga Qeveria)

Në kontabilitet dhe draft PFV, të hyrat nga grantet e shtyra¹¹, ishin prezantuar në vlerë prej 86,786€. Kjo llogari ishte e mbivlerësuar dhe ne kemi rekomanduar që të ndryshohet në 79,721€. KMDK ka marr masa për përmirësim dhe ka bërë ndryshimet e nevojshme.

Gjithashtu, KMDK me datën 29.12.16 kishte pranuar subvencion nga Qeveria e Kosovës në vlerë prej 200,000€ pa kushte mbi qëllimin e subvencionimit. Subvencioni i pranuar me 29.12.2016 ishte shpenzuar pothuaj se tërësisht (deri me 30.12.2016) kryesisht për shlyerjen e obligimeve ndaj furnitorëve dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2.3 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes llogarisë bankare të NP-së dhe kalkuloohen nga programi kompjuterik i kontabilitetit të KMDK. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave sigurohen nga sistemi i kontrolleve të brendshme, duke raportuar për: njësit, vijueshmërinë, orët e rregullat të punës, mungesat, shujtat apo punë jashtë normës së rregullt. Administrata përpilon një raport të përgjithshëm të pagave duke ju referuar raportit të njërive dhe i njëjti i dërgohet financave. Mirëpo, jo gjithmonë këto kontrolle kanë funksionuar si duhet.

Çështja 10 - Mangësi në menaxhimin e pagave - Prioritet i lartë

E gjetura Edhe përkundër kontrolleve të vendosura, KMDK kishte dobësi në kategorinë e pagave si në vijim:

- Prej janarit të vitit 2015, pagat janë rritur për 5%, rritje e cila ishte përcjell me miratimin e planit të biznesit për vitin 2015. Edhe gjatë vitit 2016 pagat ishin rritur për 2 pozita, për menaxherin e prokurimit dhe drejtorin e administratës. Mirëpo, BD nuk e kishte bërë publike deklaratën pas rritjes, dhe kjo është në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 03./L-087 për Ndërmarrje Publike ku obligon Komisionin e Auditimit të përgatis dhe publikoj një deklaratë për kompensimin e drejtoreshave dhe zyrtareve të ndërmarrjes publike. Një ndryshim i nenit 4 (aneksi 1 - tabela e kategorizimit nivelizimit të pagave) i rregullores me nr. 02/2014 për paga dhe kompensime tjera të KMDK ishte bërë në fund të korrikut nga BD pas rishikimit të buxhetit. Rritja nuk ishte reflektuar në kontratat e zyrtarëve, paga sipas kontratës figuronte pa rritje deri në fund të vitit pas përfundimit të auditimit të ndërmjetëm;

¹¹ Të hyrat e shtyra kanë të bëjnë me grantet e pranuar për mjetet nga vitet e kaluara, ku mjeti i marrë nëpërmjet grantit paraqitet i ndarë nga shuma e grantit të marrë, e cila paraqitet si një e ardhur e shtyrë në pasivën e bilancit. Mjetet e marra amortizohen dhe ngarkohen si shpenzim, ndërsa të ardhurat e shtyra kalojnë në të ardhmen përgjatë jetës së dobishme të mjetit të marr.

- Prej Janarit të vitit 2016, KMDK kishte rritur edhe vlerën e shujtës nga 2.5€ në 3€ pa një vendim paraprak, vetëm duke parashikuar rritjen në planin e biznesit pa dhënë detaje për këtë rritje. Zyrtarët e kompanisë në të kaluarën kanë marrë shujta për 50€ në muaj ndërsa me vendim të BD (24.02.15) shujta ishte ndryshuar në 2.5€ për ditë pune dhe ka filluar të zbatohet nga janari 2015. Ndërsa, rritja e shumës së shujtës për 0.5€ në ditë për vitin 2016 nuk kishte dëshmi apo vendim për aprovim nga BD deri në fund të vitit¹². Gjithashtu, rritja nuk mbështetet në baza të qarta ligjore (kontrata kolektive e cila është e zbatueshme për këtë shpenzim); dhe
- Në 8 (tetë) raste për punëtorët me kontrata për punë specifike, KMDK nuk kishte zhvilluar një proces të rekrutimit. Ligji i punës 03L/212 neni 8 e obligon punëdhënësin për shpalljen e konkursit publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Të njëjtit sipas ligjit të punës 03L/212 (neni 10 pika 8) nuk gëzojnë të drejtën për kompensime të shujtës të përcaktuar me kontratë kolektive. KMDK ka aplikuar pagesën e shujtës 3€ për çdo ditë punë edhe te këto raste. Për më tepër, kontratat janë lidhur për vendet e përhershme të punës (si zyrtar i prokurimit, zyrtar i TI, të hyrave, operator etj.) jo për ndonjë punë specifike e cila nuk mund të planifikohet, kjo ishte bërë për shkak të lëshimit të punës së disa zyrtareve si arsyetim i kushteve dhe natyrës në të cilën operon kompania.

Rreziku

Mangësitë e identifikuara rezultojnë me humbje financiare për KMDK dhe menaxhim jo adekuat të burimeve njerëzore. Moszbatimi i procedurave të rekrutimit të parapara me Ligjin e punës nuk siguron transparencë të punësimit, konkurrencë dhe trajtim të barabartë. Mungesa e vendimeve dhe aprovimeve me kohë nga BD rrezikon rritjen e shpenzimeve dhe mosrealizimin e objektivave. Pagesat e tilla rezultojnë me shpenzime të pa rregullta për paga dhe mëditje.

Rekomandimi 10 Kryesuesi i Bordit duhet t'i shqyrtoj shkaqet që kanë ndikuar në dështimin e kontrolleve dhe përsëritjen e gabimeve në menaxhimin e personelit. Të kërkojë nga Kryeshefi Ekzekutiv t'i forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të siguroj trajtim me kohe të të gjitha nevojave dhe sfidave të paraqitura.

¹² Pas përfundimit të auditimit të ndërmjetëm, me këshillën tonë përmes Memorandumit të Auditimit, Bordi i drejtorëve ka marr vendim më 23.12.2016 për ti aprovuar këto ndryshime të shumës së shujtave.

Çështja 11 - Mangësi në procedimin e pagave dhe shujtave - Prioritet i mesëm**E gjetura**

Deponit Sanitare (DS) mbajnë ditarin e punës dhe përgatisin raporte për orët e punës individuale për secilin punëtor. Këto raporte përfshijnë të dhëna si listën e punëtorëve dhe orarin e punës, raport ditor për sasinë e tonelatave të mbeturinave, raport ditor të derivateve, për makinerinë e rëndë të angazhuar, për defektet për urëmatësit, vërejtjeve dhe sugjerimet, raport i vizitave dhe raport i investimeve. Gjatë auditimit të këtyre raporteve për muajin nëntor tek Deponia Sanitare (DS) Prizren/Landovicë ne kemi vërejtur këto mangësi:

- Më 23.11.2016 nuk ishte evidentuar as hyrja as dalja e punëtorëve, përderisa me 30.11.2016 është evidentuar vetëm hyrja por jo edhe dalja, kjo nuk jep siguri mbi kalimin e normës së punës bazuar në kontratë dhe kalkulimin e shujtës që KMDK aplikon për ditë pune;
- Në një rast punëtori kishte punuar më shumë se norma e përcaktuar me kontratë dhe KMDK nuk i ka paguar orët shtesë. Sipas deklaratës verbale punëtorët kompensohen me ditë të lira, mirëpo mungon një evidencë e mirëfilltë apo kalkulim për ditët e lira që i takojnë apo si të kalkulohet shujta në këto raste;
- Në dy raste tjera, nuk ishin plotësuar orët efektive sipas kontratës, mirëpo paga ishte e plot dhe mungonin shënimet plotësuese / dëshmitë në ditar për arsyetimin e kësaj gjendje;
- Në një rast, raportimi i orarit të punës për punëtor (13 ditë pune) nuk përputhet me ditarin e punës (që ka të evidentuar 14 ditë pune). Për më tepër, ka gabime në raportimin e datave ato ndryshojnë në këto dy dokumente edhe pse duhet të jenë të njëjta. Raporti mbi orarin e punës nuk ishte i nënshkruar nga përgjegjësi i DS; dhe
- Sipas zyrtareve, raportimi ishte bërë para fundit të muajit dhe kjo kishte shkaktuar kalkulim jo të plot të shujtës tek dy raste, të cilat barten për tu paguar në muajt vijues.

Rreziku

Mangësitë e identifikuar nuk japin siguri mbi vendosjen e kontrolleve adekuate në fushën e pagave dhe kjo mund të rezultojë me pasaktësi në pagesën dhe prezantimin e pagave.

Rekomandimi 11

Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që janë vendosur kontrolle të brendshme dhe të monitoroj sistemin e raportimit me qëllim të pagesës dhe prezantimit të saktë dhe të plotë për paga dhe mëditje.

3.2.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 794,765€. Shpenzimet e faturuara të periudhës janë prezantuar në pasqyrën e të ardhurave në vlerë prej 701,876€. Ato kanë të bëjnë me udhëtimet zyrtare, riparim dhe mirëmbajtje, shpenzimet e vajrave dhe naftës, shërbime konsulente, shpenzime administrative, shpenzimet e periudhave të më hershme, shpenzimet e kamatës, rekreacionit, reprezentacion, furnizim për zyre, qira, komunal, shpenzim të telefonit dhe shpenzim tjera.

Çështja 12 - Mangësi në faturimin dhe pagesat për mallra dhe shërbime - Prioritet i mesëm

E gjetura KMDK edhe përkundër vendosjes së një sistemi të kontrolleve për faturimin dhe pagesat për mallra dhe shërbime, kishte dobësitë si në vijim:

- Në katër raste, në vlerë 366€, shpenzimi i parasë së imtë nuk e kishin miratimin paraprak të kërkesës për shpenzim nga zyrtari kompetent;
- Me rastin e 8 Marsit me vendim të BD ishin shpërblyer zyrtaret e KMDK me nga 70€. Vendimi nuk specifikon numrin e saktë të zyrtarëve dhe pagesa është bërë nga paraja e imtë.
- Në katër raste, KMDK kishte marrë veturë me qira pa kontratë apo marrëveshje paraprake, vlera e shërbimit ishte 496€, kjo për shkak të mungesës së veturave zyrtare dhe udhëtimeve jashtë vendit. Për më tepër raporti i punës është i mbështetur në të dhënat verbale pa dëshmi paraprake, kontratë, marrëveshje apo ofertë financiare;
- Publikimi në gazetë, për një konkurs në vlerë 80€ ishte bërë pa ndonjë marrëveshje paraprake apo vendim të menaxhmentit; dhe
- KMDK nuk ka të përcaktuar limitin për pagesën e telefonave fiks apo një politik që rregullon këtë fushë. Shpenzimi i faturuar vetëm për një numër fiks, ishte në vlerë prej 130€ të shpenzimeve totale për muajin tetor/2015 dhe ishte paguar në 2016. Për më tepër kjo faturë figuron me borxhe nga viti paraprak prej 192€.

Rreziku Mos miratimi paraprak i kërkesave për blerje, mangësitë në përcaktimin e numrit të përfituesve, mungesa e marrëveshjeve, mungesa e politikave për limitimin e shpenzimeve reflektojnë në kontrolle të dobëta dhe rrezikojnë që të bëhen shpenzime dhe pranime jo të rregullta të mallrave apo shërbimeve.

Rekomandimi 12 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj kontrolle më të fuqishme mbi inicimin, aprovimin, monitorimin dhe pagesën nga kjo kategori. Me qëllim të monitorimit sa më adekuatë të këtyre shpenzimeve duhet të nxjerrën rregulla shtesë që vendosin kontrolle mbi shpenzimin e parasë publike për këtë kategori.

3.2.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 182,000€ ndërsa realizimi gjatë këtij viti ishte 184,370€. Shpenzimet për kapitale kanë të bëjnë me blerjen e një kamioni, investimi në DS si puset, gypa për ajrorej, gazifikim, kompjuterë, printerë servisime, etj.

Çështja 13 - Mangësitë në shërbime të kontraktuar - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Mangësitë e identifikuara në këtë kategori janë si në vijim:
- Në një rast, furnizimi me kompjuter (Lap-top), prej 820€ nuk ishte bërë sipas kontratës. Sipas komisionit janë pranuar kompjuter me Hard Disk prej 500GB edhe pse KMDK kishte kontraktuar dy kompjuter me specifika prej 750GB, kjo për shkak se furnizuesi nuk kishte ofruar mallrat sipas kontratës në momentin e liferimit; dhe
 - Tek rastet furnizim me Primol në vlerë 407€, filtra për makineri me vlerë 1,150€, furnizim dhe punë për kamionin Iveco me vlerë 1,343€, dhe deratizimi, dezinfektimi, dezinfektimi me vlerë 41,466€ nuk është përgatitur raporti i pranimit të furnizimeve apo shërbimeve, por ka vetëm raport pune të projekt menaxherit. Projekt menaxheri, raportin e punës e përpilon në bazë të komisionit që ndodhet në teren. Pra, projekt-menaxheri nuk i përcjell direkt punët e përmbushjes së kontratës, por përgatitë vetëm raporte pune.
- Rreziku** Mangësitë e identifikuara rrezikojnë që pranimi i punëve apo pajisjeve të jetë jo cilësor dhe jashtë kushteve kontraktuese.
- Rekomandimi 13** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur kontrollet adekuate dhe janë respektuar obligimet kontraktuese, për çmimet dhe cilësinë e pranimit të mallrave të kontraktuara.

3.3 Pasuritë

3.3.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

KMDK ka pasuri fikse të grupuara në tri kategori: Deponitë Sanitare si kategori e parë, pajisje dhe vetura në kategorinë e dytë dhe kategorinë e tretë buldozerët, kamionët, pjesët rezervë etj.

Norma e amortizimit dhe kategorizimit të këtyre pasurive është trashëguar nga e kaluara dhe në disa raste nuk përputhet me politikat e ATK-së. KMDK nuk ka një politikë të shkruar mbi kategorizimin dhe zhvlerësimin e pasurive. Vlera neto e pasurive jo qarkulluese në pronësi të KMDK me 31.12.2016 ishte 2,472,492€.

Struktura dhe ndryshimet tek këto pasuri janë dhënë në tabelën me poshtë:

Tabela nr. 4 Pasuritë sipas kategorive dhe shumave në €

Përshkrimi	Kategorija1	Kategoria 2	Kategoria 3	Totali
Kosto historike (Vlera blerëse)	10,030,337	103,351	2,353,440	12,487,128
Zhvlerësimi i akumuluar (deri 2015)	(7,280,912)	(77,868)	(1,968,246)	(9,327,026)
Blerjet gjatë vitit 2016	30,573	130,141	23,656	184,370
Rivlerësimi i pasurive	0	0	0	0
Zhvlerësimi i vitit	(732,855)	(24,125)	(115,000)	(871,980)
Vlera neto në libra me 31/12/2016	2,047,143	131,499	293,850	2,472,492

Çështja 14 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura

Për shkak të evidencave nga e kaluara, KMDK kishte mangësi në evidentimin dhe prezantimin e këtyre shpenzimeve:

- Në kategorinë e parë të pasurive, KMDK kishte evidentuar "Vlerësimi i deponisë Prishtinë " blerje në vitin 2008, përderisa kishte aplikuar zhvlerësimin nga 2006. Tek e njëjta kategori "Investimi në deponinë në Prizren" evidentuar si blerje në vitin 2011, KMDK kishte aplikuar zhvlerësim nga 2010. "Meremetimi i infrastrukturës Prishtinë, montimi i shtyllave në Gjilan" dhe "Investimi në Prizren" ishin evidentuar si të veçanta pa datë blerje duke aplikuar zhvlerësim nga viti 2010 respektivisht 2012 dhe kishin jetëgjatësi tjetër në krahasim me DS;

- Në kategorinë e dytë një pajisje me përshkrim “ipko” me vlerë prej 195€ ishte evidentuar si pajisje dhe kishte zhvlerësim nga 2009 edhe pse realisht ishte shpenzim. Disa pasuri në këtë kategori nuk kishin datë të blerjes dhe disa tjera nuk kanë përshkrim të pajisjes (ngjarje kjo nga 2010/2011). Për me tepër “blerja e veturës” prej 30,175€ evidentuar në 2006 kishte vlerë të mbetur në 2014 prej 2,351€, nuk ishte zhvlerësuar sipas kërkesave duke nënvlerësuar shpenzimin e zhvlerësimit për të njëjtën vlerë në po atë vit. Vetura “Mitsubishi” nuk ka datë të evidentimit në këtë regjistër. Disa pajisje që ishin zhvlerësuar nëpër vite dhe nuk kishin vlerë të mbetur ishte aplikuar gabimisht zhvlerësimi duke ngarkuar shpenzimin e zhvlerësimit 2,015€ më shumë vetëm për vitin 2016;
- Në kategorinë e tretë, KMDK në pesë raste kishte evidentuar gjatë vitit 2012 “investime për buldozher dhe Iveco Ferizaj” në vlerë prej 14,385€ si pajisje dhe ishin zhvlerësuar edhe pse ishin shpenzime, kjo për shkak të evidencave të bartura gabimisht nga e kaluara; dhe
- Gjithashtu, sipas standardeve kërkohet të bëhet rivlerësim i pasurive, mirëpo KMDK nuk kishte bërë rivlerësim të pasurisë si shkak i mungesës së ekspertëve për këtë lëmi.

Rreziku Mangësitë e identifikuara reflektojnë prezantim jo të drejt dhe të plot të shpenzimit të zhvlerësimit dhe gjendjes real të pasurisë.

Rekomandimi 14 Kryesuesi i Bordit duhet të zbatoj një plan të detajuar të kontrolleve duke siguruar mekanizma shtesë për evidentimin dhe eliminimin e këtyre gabimeve me qëllim të prezantimit të saktë dhe të plot të PFV.

3.3.2 Trajtimi i parasë së gatshme

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshinë bilancet e parave të gatshme në llogaritë bankare dhe në arkë. KMDK, në fillim të vitit 2016 sipas PFV kishte prezantuar para në vlerë prej 14,931€ ndërsa në fund të vitit kjo vlerë ishte 55,065€. Sipas konfirmimit të bankës dhe komisionit për mbyllje të arkës kjo gjendje nuk përputhet për shkak se 700€ të tërhequra me datë 30.12.2016 si rimbushje e arkës nuk figurojnë në raportin bankar si dalje e parasë në këtë muaj por kjo është reflektuar tek në muajin janar 2017.

Arkëtimi i parasë vetëm nga aktivitetet operative sipas pasqyrës së rrjedhës së parasë, ishte në vlerën prej 1,990,346€, krahasuar me vitin paraprak prej 1,680,630€ arkëtimi i parasë ishte më i lartë prej 309,716€. Shpenzimi i parasë vetëm për aktivitetet operative ishte 1,965,842€.

Arkëtim të parasë nga aktivitetet financiare, KMDK ka prezantuar Subvencionimin nga qeveria prej 200,000€, krahasuar me vitin e mëparshëm prej 59,347€ kjo vlerë është rrit për 140,653€. Shpenzimi i parasë për aktivitet investuese ishte në vlerë prej 184,370€.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të KMDK janë shuma të mjeteve që klientët i detyrohen ndërmarrjes për shërbimet që i kanë përfituar nga ndërmarrja, të arkëtueshme tjera ndaj TVSH në blerje dhe “Llogari të arkëtueshme të dyshimta”.

Çështja 15 - Mangësitë në menaxhimin e llogarive të arkëtushem - Prioritet i lartë

E gjetura KMDK nuk kishte arritur të menaxhoj si duhet këtë llogari, mangësitë e identifikuar janë prezantuar në vijim:

- Nga 14 kërkesat tona për dërgimin e letër konfirmimeve për llogarit e arkëtueshme, 3 nuk janë dërguar për shkak të mungesës së kontakteve dhe borxheve të vjetruara. Ne kemi pranuar vetëm dy konfirmime dhe në njërin rast diferenca e nënvlerësuar në kontabilitet ishte prej 1,913€ e cila është rregulluar pas rekomandimit tonë, ndërsa te klienti tjetër diferenca e nënvlerësuar ishte prej 14,549€ e cila vazhdon të nënvlerësoj këtë llogari. Kjo për shkak se kompania ka trashëguar një kontabilitet të parregullt nga vitet e kaluara dhe mungesës së një barazimi/harmonizimit të këtyre llogarive me blerësit si masë kontrolli;
- Të arkëtueshmet tregtare në vlerë prej 24,448€ nga “konsumatorët privat” nuk mund të identifikohen se kujt i takojnë, kjo për shkak se janë llogari të trashëguara dhe janë të regjistruara në kontabilitet si blerës të pa njohur. Për më tepër, dy llogari kishin vlerë negative 211€ të cilat e zvogëlojnë këtë kategori dhe kjo ka ndodhur për shkak të regjistrimit jo të saktë në kontabilitet; dhe
- KMDK ka prezantuar në PVF edhe të arkëtushme tjera nga “shteti dhe institucionet” në vlerë prej 5,248€ e cila sipas kontabilitetit ka të bëjë me TVSh në blerje dhe avancet e punëtorëve. Ne kemi verifikuar një kreditim të TVSh sipas deklaratës se muajit dhjetor të vitit 2016 në vlerë 5,056€ e cila nuk përputhet me vlerën e prezantuar në PVF dhe në mungesë të regjistrimit analitik, ne nuk jemi në gjendje të konfirmojmë saktësinë e kësaj llogarie. Vlera e kësaj llogari sipas kontabilitetit së bashku me stoqet prej 25,810€ ishte zvogëluar për 2,100€ për shkak të regjistrimit të një “llogari të dyshimte” si regjistrime të parregullta kontabël. .

Rreziku Shënimet kontabël nuk japin pasqyrim të drejt për llogaritë e arkëtueshme duke rezultuar në pasqyrim jo të qëndrueshëm për nevoja të raportimit financiar.

Rekomandimi 15 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurohet se është bërë harmonizimi i shënimeve kontabël të arkëtushmeve me qëllim të paraqitjes dhe prezantimit të drejt në përputhje me standardët e raportimit financiar. Gjithashtu, të vlerësoj nxjerrjen e një politike kontabël në bazë të standardeve dhe rregullave në fuqi për lejime dhe borxhet e këqija.

3.4 Kapitali dhe Detyrimet

3.4.1 Kapitali

Në Pasqyrat Financiare Vjetore, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Përshkrimi	Me 31/12/2016	Me 31/12/2015
KAPITALI	4,482,406	4,799,955
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Kapitali rezerve	11,116,909	11,116,909
Fitimet/Humbjet e bartura	(6,341,954)	(5,682,502)
Fitimet/Humbja e vitit aktual	(323,778)	(659,459)
Rezerva e rivlerësimit	6,229	0

KMDK ka operuar me humbje nga themelimi deri me tani, kjo si pasoj e tarifave të ulta dhe kostos së lart të shërbimeve të cilat nuk mund të mbulohen nga të hyrat e realizuara. Humbja është pasoj edhe e vlerës së lart të zhvlerësimit të pasurive që posedon KMDK. Mirëpo, përkundër këtij fakti KMDK si kompani publike e themeluar nga Qeveria pret mbështetjen e sajë, me grande dhe subvencione. Për më tepër, operimi i kësaj kompani është i domosdoshëm për menaxhimin, zhvillimin dhe kontrollin e sektorit të mbeturinave.

Mangësitë në raportimin e ekuitetit në PVF dhe në kontabilitet janë prezantuar tek kapitulli i Opinionit të Auditimit.

3.4.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve dhe shtetit në fund të vitit 2016 ishte 690,750€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga KMDK dhe është shqyrtuar më në detaje në nënkapitullin 3.3.

Detyrimet afatshkurta të prezantuara në PFV janë: obligime ndaj furnitorëve në vlerë 421,402€, obligimet për tatime dhe kontribute në vlerë prej 267,432€ dhe obligime ndaj të punësuarve dhe të pagueshme tjera në vlerë prej 1,916€. Krahasuar me vitin e kaluar prej 1,176,660€ ka trend ulës të të pagueshmeve prej 41%.

Detyrimet tjera të prezantuara në PFV kanë të bëjnë edhe me detyrimet afatgjata për avancet (grantet) në vlerë prej 158,582€.

Krahasuar me detyrimet afatgjata të vitit 2015 prej 408,785€ tregojnë trend rënës prej 61% kjo për shkak të regjistrimeve të bartura gabimisht nga vitet e kaluara që vlerën e detyrimeve të vitit paraprak nuk e kanë bartur saktë.

Çështja 16 - Mangësitë në menaxhimin e detyrimeve - Prioritet i lartë**E gjetura**

Gjatë testimit të kësaj kategorie kemi vërejtur mangësitë në vijim:

- Për rastin e marrëveshjes për pagesën e borxhit sipas aktgjykimit nr. 3332/2009 detyrimi fillestarë ishte prej 184,755€, ndërsa vlerën prej 57,214€ (detyrimi nga 2008), KMDK kishte dështuar ta tregoj si obligim për shkak të mos evidentimit me kohë të detyrimit. Për të njëjtën situatë, KMDK kishte bërë disa rregullime në kontabilitet duke rritur detyrimet ndaj kompanisë mirëpo këto ndryshime nuk ishin në përputhje me standardet dhe nuk japin një pasqyrim të drejt. KMDK i kishte paguar me 5 këste kontraktorin, detyrimin për 2007/2008/2009 në vlerë 214,371€ duke shtuar edhe shpenzimet e përmbarimit në vlerë prej 4,657€ shpenzim të gjykatës prej 1,222€ dhe 50€ për ekspertizën financiare dhe interesit në vlerë prej 87,210€ si vlera totale e borxhit prej 307,513€. KMDK për shkak të vonesave obligohej që nga buxheti i sajë të paguaj 93,139€ me tepër se sa faturimi/detyrimi real. Kjo kishte pasur me një rishikim të planit të biznesit dhe shmangieje nga disa objektiva të përcaktuara me planin fillestar.
- Nga 21 kërkesat tona, për letër konfirmimet për llogarit e pagueshme, vetëm 13 janë dërguar, katër nga to nuk janë dërguar fare dhe për tri nuk kemi arsyetim nga KMDK pse nuk janë dërguar. Ne kemi pranuar pesë letër konfirmime, dy prej të cilave kanë dërguar qarkullimin e vitit jo gjendjen finale, njëra përputhet me shënimet e kontabilitetit dhe dy konfirmime të pranuar nga furnitori rezultojnë me gabime, njëra është mbivlerësim prej 2,000€ dhe tjetër është nënvlerësim prej 2,000€. Për më tepër në katër raste si llogari të pagueshme figurojnë vlera negative prej -17,913€ për shkak të regjistrimeve të gabuara apo pagesave më tepër ndaj furnitorëve. Disa konto janë të evidentuar si konto të "përkohshme" apo konto me emërtimin "i panjohur" për shkak të regjistrimit të gabuar nga e kaluara.
- Në një rast, KMDK kishte paguar për ATK vlerën prej 1,372€ si shpenzim të interesit dhe ndëshkimit për shkak të deklarimit të vonuar të kontributeve pensionale të janarit 2015 (obligimi i deklaruar për këtë periudhë ishte vetëm 4,234€ duke i shtuar edhe 1,372€ për interes dhe ndëshkime). Pagesa prej 5,607€ ishte bërë me 03.03.2016, më shumë se një vit vonesë për shkak të vështirësive financiare.

- Nga data 21.07.2016 KMDK ka një marrëveshje me ATK për pagesën e borxhit në vlerë prej 364,494€ deri me 20.07.2019, me kusht që pagesa para marrëveshjes të jetë 20,000€ dhe pagesat tjera me 36 këste nga 10,125€. Tatimi bazë për këtë marrëveshje ishte 237,711€ ndëshkimi 70,221€ dhe shpenzimi i interesit 76,562€. Marrëveshja është lidhur për obligimin e papaguar nga e kaluara, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë evidentimin e saktë në kontabilitet të këtyre detyrimeve pasi nuk kemi pranuar konfirmim apo gjendje finale nga ATK. Këto detyrime në PVF finale janë prezantuar në vlerë prej 267,432€.
- Detyrimi afatgjatë për të hyrat e shtyra nga grandit janë prezantuar 158,583€ në PVF, mirëpo gjendja e bartur nga viti i kaluar prej 408,785€ ishte e pa saktë pasi në pasqyrën e të ardhurave Kompania ka njohur të hyra nga grandet e shtyra vlerën prej 79,721€, e jo 250,203€ sikurse është zvogëluar dhe prezantuar në PVF. Kjo ka ndodh si pasojë mos evidentimit me kohë të këtyre ndryshimeve në kontabilitet nga vitet e mëshme.

Rreziku Mangësitë e identifikuar pamundësojnë prezantimin e saktë dhe të plot të detyrimeve në PVF. Gjithashtu, mungesa e një harmonizimi midis kontabilitetit dhe furnitorëve mundëson edhe pagesa të parregullta.

Rekomandimi 16 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marr masat e nevojshme për njohjen real të detyrimeve sipas standardit të kontabilitet, për njohjen e provizioneve për raste kur kompania obligohet që të transferojë përfitime ekonomike si rrjedhojë e transaksioneve ose ngjarjeve nga e kaluar. Me qëllim të evitimit të gabimeve, të bëhen harmonizimet e kontabilitet me furnitorët duke trajtuar saktësinë dhe plotësinë e këtyre llogarive.

3.4.3 Trajtimi i detyrimeve Kontigjente

Sipas Standardeve detyrimet kontigjente përkufizohen si një obligim i cili është rrjedhojë e ngjarjeve të kaluara dhe vlera monetare e obligimit nuk mund të matet me besueshmëri të mjaftueshme. Këto kane të bëjnë me rastet gjyqësorë/padit që KMDK ka shpallur në PVF.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna (2015)	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1. Prona, bartja në periudhë dhe ruajtja	Jemi të mendimit se duhet bërë testimi i dëmit të aseteve në baza periodike në mënyrë që të përcaktohet vlera e rikuperueshme e aseteve, ose nëse kompania ka mundësi dhe nëse në nivel të vendit ka institucion të ekspertit vlerësues, të angazhohen vlerësues të pavarur dhe profesional të cilët do të përcaktojnë vlerën reale të aseteve.			Prona impiantet dhe pajisjet janë bartur me kosto të tyre duke hequr zhvlerësimin dhe rekomandimi i dhen për testimin e demit të aseteve nga vlerësuesit apo eksperte nuk është zbatuar as këtë vit.
2. Provizionet për rastet gjyqësore/detyrimet kontigjente	Kërkohet njohja e provizioneve për rastet gjyqësore (posaçërisht ato me rrezikshmëri të lartë dhe të humbura në procese gjyqësore) në harmoni me kërkesat e ligjore si dhe të standardeve të kontabilitetit. Kjo do të bënte që biznesi të ka informata më të sakta mbi gjendjen e detyrimeve të kompanisë.			Deklarimi apo njohja e provizionet për rastet gjyqësore me qëllim të vlerësimit real të detyrimeve nuk është zbatuar ende.
3. Llogarite e arkëtueshme	Ne rekomandojmë menaxhmentit e kompanisë të përlllogarisë në baza të rregullta periodike dhe vjetore dëmin e llogarive të arkëtueshme dhe të prezantoj llogaritë e arkëtueshme në vlerën e tyre neto të rikuperueshme. Këto veprime konsiderojmë se duhet të bazohen në rregullativën ligjore të Kosovës (ligjet e lartpërmendura), si dhe rregulla e standarde të cilat rregullojnë këtë lëmi.			Njohja e provizioneve për borxhet e këqija për llogarit e arkëtueshme e cila reflekton me njohjen real të pasurisë nuk është Zbatuar ende.

Shtojca IV: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS Zyra Kombëtare e Auditimit NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE NATIONAL AUDIT OFFICE			
31.05.2017			
Numri i Dokumentit	Numri i Aktit	Numri i Prokurimit	Numri i Dokumentit
23	23.18	595	1

KMDK SH.A		Dalëse <input checked="" type="checkbox"/>	Kyresë <input type="checkbox"/>
№:	426/2017		
Çelësi:	31/05/2017		
Kompani për Menaxhimin e Depozitave të Kosovës SH.A. Kosovo Lendë Management Company LLC Kompanija za Upravljanje Depozitama u Kosovu DOO			

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Kompania për Menaxhimin e Depozitave të Kosovës Sh.A., për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet, ndërsa përmbajtja dhe shprehjet mendojmë se janë jo adekuate me të gjeturat; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Lundrim Camaj

Kryesues i Bordit të Drejtoreve

Data: 31.05.2017, Prishtinë,

Z. Abdullah Haxhiu

Kryshef Ekzekutiv,

Data: 31.05.2017, Prishtinë,